

VENDIM
Nr.595, datë 31.8.2006

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT “POSTA DIREKTE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 9 e 6, pika 3 të ligjit nr.8530, datë 23.9.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e tarifave të shërbimit “Posta direkte”, për kufijtë e zonës së rezervuar, sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TARIFAT E POSTËS DIREKTE

Tabela nr.1

Pesha gr	Tarifat bazë në lekë	1-1000 cp.	1001-10000	10001-50 000	50001-100000	100001-200000	200001-500000
0-20	40	40	30	28	26	24	22
21-50	50	50	32	30	28	26	24
51-100	55	55	35	33	31	29	27